

**EMINE BAKALLI**

**PROGRAMI I ZORAN GJINGJIQIT PËR KOSOVËN  
APO PROGRAMI SERB PËR KOSOVËN<sup>1</sup>**

**Minimi i procesit drejt pavarësisë së Kosovës:**

**“Federalizimi i Kosovës” si premisë për ndarjen e saj**

Kreativ në mendim, imponues dhe energjik në veprim ish kryeministri serb Zoran Gjingjiq (2001- 2003), pas një angazhimi të përqendruar përfundoi Programin për Kosovën në dhjetor 2002<sup>2</sup>. Ky program me titull *Strategjia për Kosovë e Metohi*<sup>3</sup>, fillimisht iu prezantua një rrethi të ngushtë entitetesh politike e shtetërore siç ishin, organet kryesore shtetërore serbe si dhe organizatat kryesore serbe në Kosovë. Programi në fjalë u publikua pas vdekjes së tij si pasojë e atentatit të organizuar nga forcat ultrakriminale serbe. Iniciativën për botimin e këtij programi e mori Këshilli Nacional Serb i Kosovës, më konkretisht kjo u bë nën përkujdesjen e kryetarit të këtij Këshilli, M. Ivanoviq. Sipas këtij të fundit, Gjingjiqi u përqendrua në çështjen e Kosovës, pasi u ballafaqua

<sup>1</sup> Deri tani nuk më ka rënë në sy as kur po përgatisja temën “Kosova shtet i pavarur dhe sovran”, fundi i vitit 2006 për Tryezën shkencore të organizuar nga ASHAK (botuar në vitin 2007), e as më vonë, që në shkrimet, vështrimet apo debatet televizive në arealin shqiptar të evidencohet a të përmendet programi i ideuar nga ky personalitet i politikës serbe, në ndërkohë që përmenden programe të tjera para dhe pas tij. Në intervistën që po bënte një gazetar i njohur kosovar me presidentin serb Boris Tadiq, po i drejtohej me një pyetje në kuptimin përse ky kishte devijuar nga politika e moderuar e Gjingjiqit ndaj Kosovës. Tadiqi spontanisht filloi me një “Po Gjingjiqi...” dhe për një moment u ndal, e shikoi habitshëm gazetarin kosovar dhe vazhdoi me një fjali të re pa “Gjingjiqin” brenda saj. Edhe unë si shikuese mbeta e habitur: A thua ky gazetar nuk e ka lexuar *Strategjinë për Kosovën e Metohinë* të botuar në Beograd që në vitin 2003, si dhe intervistat dhe paraqitjet e Gjingjiqit së paku në shtypin serb? Sepse kushdo që do t’i ketë lexuar këto do të ishte i informuar se gjithçka në politikën serbe lidhur me Kosovën, sidomos nga fillimi i vitit 2003 është taktikë në plan të gjerë dhe veprim në terren (Kosovë) në funksion të strategjisë politike të përvijuar pikërisht nga Gjingjiqi.

<sup>2</sup> *Zoran Gjingjiq o Kosovu*, Beograd: UG “Cer” 2003, f. 12.

<sup>3</sup> “Strategjia o K i M”, botuar në *Zoran Djindjić o Kosovu*, Beograd, UG “Cer” 2003, f. 12-17.

me faktin se në këtë plan të tjerët para tij dështuan dhe çështja “po merrte tatëpjetën”<sup>4</sup>. Sipas vlerësimeve të tij, institucionet serbe në Kosovë po shuheshin ndërsa serbët po integroheshin në “institucionet shqiptare” me ç’rast lidhjet me Serbinë po ndërpriteshin. Krahas kësaj, Rezoluta 1244 e OKB<sup>5</sup> po eklipsohej nga Korniza Kushtetuese<sup>6</sup> me ç’rast po ndodhte funksionalizimi i institucioneve shtetërore të Kosovës dhe kjo po merrte tiparet e një shteti praktikisht të pavarur.

Serbët e Kosovës- organizatat e tyre politike, Programin e Gjingjiqit të aprovuar nga qeveria serbe dhe koalicioni qeverisës i kohës, e miratuan dhe e konsideruan si të vetmen rrugë për “zgjidhjen e çështjes së Kosovës”<sup>7</sup>. Më 28 janar 2003, përfaqësuesit e entiteteve politike serbe të Kosovës në një takim me kryeministrin Gjingjiq, u pajtuan për veprim të përbashkët në jetësimin e strategjisë së tij për Kosovën. Pas këtij takimi deputetja e Parlamentit të Kosovës, anëtarja e Povratak-ut Rada Trajković, ndër të tjera deklaroi se ky program do të bashkojë të gjithë ata që do të angazhohen për realizimin e tij dhe do të eliminojë “ata që do të angazhohen kundër dhe jashtë këtij plani” i cili “në esencë nënkupton bashkimin”<sup>8</sup>. Sipas Gjingjiqit, diplomacia dhe politika e Serbisë në bashkëveprim me organizmat politikë të serbëve në Kosovë e kishin për detyrë që menjëherë e pa humbur kohë të ndërmerrnin hapa energjikë, në mënyrë që rrjedhat drejt shtetit të pavarur të Kosovës të pengoheshin dhe krahas kësaj të krijoheshin premisat për ndarjen e saj.

Gjingjiq, shumë shpejt pasi mori postin e Kryeministrit doli me tezën se e gjithë ajo që po ndodhte në “jugun e Serbisë” (nënkupto: Kosovë) po dhe në Maqedoni (nënkupto: luftën e shqiptarëve për të drejtat e tyre), e zhvlerësonte arsyetimin se “reaksioni shqiptar” kishte të bënte me politikën e “keqe të Millosheviqit”<sup>9</sup>. Gjatë vizitës së parë në

<sup>4</sup> Po aty, f. 12.

<sup>5</sup> Rezoluta 1244 për Kosovën e aprovuar nga Këshilli i Sigurimit i OKB më 10 qershor 1999, parashihte administrimin e përkohshëm ndërkombëtar në Kosovë pa e përjashtuar sovranitetin dhe integritetin territorial të RF të Jugosllavisë.

<sup>6</sup> Korniza kushtetuese e vetëqeverisjes së përkohshme në Kosovë u miratua nga UNMIK, më 15 maj 2001. Në nenin 1.1 të saj, Kosova përkufizohej si entitet me veçori etnike (populli i vet), historike, juridike, kulturore dhe gjuhësore.

<sup>7</sup> Zoran Gjingjiq *o Kosovu ...*, f. 29

<sup>8</sup> Po aty, f. 32.

<sup>9</sup> Po aty, f. 57. Intervistë dhënë gazetarëve serbë në hotelin “Hilton” në Berlin më 10 mars 2001. I pyetur për gjendjen në “jug të Serbisë” ai u përgjigj: “Sa i përket gjendjes në jug të Serbisë dhe tani në Maqedoni, tashmë është e qartë se nuk mund të vazhdohet

Gjermani në cilësinë e kryeministrit (mars 2001), ai para gazetarëve shpërfaqti domosdonë që faktori ndërkombëtar natyrisht me asistencën serbe të ballafaqohet me “ekstremizmin shqiptar” si një “sëmundje”, duke theksuar se heshtja e saj nuk ndihmon, përkundrazi e përkeqëson atë. Në të kundërtën forcat ndërkombëtare do të pësonin humbje nga “terrorizmi shqiptar” dhe nga Kosova do të tërhiqeshin të turpëruara<sup>10</sup>.

Fushata politike, diplomatike dhe propaganduese serbe u përqendrua në imponimin e “temës” për zgjidhjen e “çështjes madhore për paqen në Ballkan”-çështjen e statusit të Kosovës. Çdo intervistë, paraqitje publike brenda e jashtë Serbisë dhe kuptohet aktiviteti diplomatik i Gjingjiqit, në thelb kishte ofensivën marramendëse në favor të tezës serbe për Kosovën e dy entiteteve paralele. Faktori ndërkombëtar duhej të kuptonte se në të kundërtën do të rrezikohej demokracia në Serbi dhe stabiliteti në Ballkan, me ç’rast do të shtrohej nevoja për kufij të rinj që do të thoshte kthimin në vitin 1990<sup>11</sup>. Kryeministri serb po e akuzonte Bashkësinë Ndërkombëtare për mungesë reflektimi ndaj Rezolutës 1244, e cila i garantonte “shtetit amë” kthimin e një kontingjenti të ushtrisë dhe policisë serbe si dhe kthimin e të përndjekurve; se ajo praktikisht po e krijonte shtetin e pavarur të Kosovës pa përfillur “mbrojtjen e të drejtave të Serbisë”<sup>12</sup>. Në një intervistë për gazetën prestigjioze gjermane *Der Spiegel* (1 janar 2003), Gjingjiqi shpërfaqte mendimin se mundësia që “shqiptarët” të shpallnin pavarësinë “do të paraqiste një precedentë të rrezikshme për popujt e Ballkanit” dhe do të rrezikonte paqen sidomos në Bosnje e Hercegovinë. Sipas tij “çështja e Kosovës” do të duhej të zgjidhej sipas modelit të federatës myslimane-serbe në këtë shtet. Nëse shqiptarët nuk do ta pranonin këtë solucion, atëherë Gjingjiqi paralajmëronte kërkesën e tij për një konferencë të re “të Dejtonit”, e cila do të siguronte paqen duke krijuar kufijtë e rinj në rajon. Në fakt, ideja e “federalizimit të Kosovës” përmes formimit të bashkësisë serbe brenda së

---

që gjithçka të arsyetohet me politikën e keqe të Millosheviqit, dhe që duhet të kihet mirëkuptim për reaksionin e shqiptarëve”.

<sup>10</sup> *Blic*, 4 mars 2001.

<sup>11</sup> *Večernje Novosti*, 14 janar 2003; Në takim me ministrin e Jashtëm grek Papandreu (Greqia kryesuese e radhës së BE); Ndërsa në një paraqitje televizive në Sarajevë Gjingjiqi deklaroi se të gjithë ata që sot thonë “Nuk çon peshë nëse Kosova bëhet e pavarur, çka të bëjmë le të bëhet, nesër do të thonë nuk e kemi ditur që ky do të jetë fillimi i një reaksioni zinxhir, i cili gjithë Ballkanin do ta kthejë në vitin 1990” (*Politika*, 8 shkurt 2003).

<sup>12</sup> *Zoran Gjingjiq o Kosovu ...*, f. 32.

cilës do të siguroheshin “të drejtat kolektive” të tyre e përcjellë me “garancinë që forcat shqiptare dhe policia nuk mund ta pushtojnë atë”, ishte në agjendën e kryeministrit serb që në gjysmën e dytë të vitit 2001<sup>13</sup>. Gjingjiqi i pari ndër politikanët serbë u distancua dhe hoqi dorë nga koncepti multietnik për Kosovën me arsyetimin se serbët dhe shqiptarët nuk mund të jetonin së bashku.

Kryeministri energjik serb, krahas faktorizimit të Serbisë në rrafshin ndërkombëtar në plan të parë kishte dhe “imponimin e temës për Kosovën” dhe përpunimin e faktorit ndërkombëtar në drejtim të përgatitjes së terrenit për pranimin nga kjo anë të federalizimit<sup>14</sup> të Kosovës përmes dy entiteteve nacionale. Në fillim të shkurtit 2003, ai iu drejtua anëtarëve të Këshillit të Sigurimit të OKB me një shkresë përmes së cilës i njoftonte për shqetësimet e “qeverisë demokratike” të Beogradit për rrjedhat në Kosovë. Sipas tij, zhvillimet në Kosovë ishin në kundërshtim me thelbin e Rezolutës 1244 gjë që rrezikonte jo vetëm stabilitetin në Serbi po dhe në gjithë Ballkanin<sup>15</sup>. Në këtë shkresë theksohej se KFOR\* dhe UNMIK\* “kompetencat e Serbisë dhe Jugosllavisë” shkallë-shkallë po i baritnin në strukturat qeverisëse vendore të Kosovës, gjë që do të rezultonte me një shtet praktikisht të pavarur, përveç njohjes ndërkombëtare. Duke u nisur nga konstatimi se shqiptarët nuk i duan serbët në territorin e tyre dhe në anën tjetër serbët nuk ndihen të sigurt në mesin e tyre, Gjingjiqi propozonte krijimin e dy entiteteve nacionale. “Është e domosdoshme që serbëve në Kosovë t’u pranohet statusi i bashkësisë nacionale”, kërkonte ai. Në këtë shkresë,

<sup>13</sup> *Blic*, 4 maj 2001; Para këtij solucioni ai angazhohej për Kosovën multietnike brenda së cilës interesat serbëve do të mbroheshin në rrugë institucionale në mënyrë që mos të lejohej majorizimi i tyre (Gjingjiqi në një takim me përfaqësuesit e serbëve të Kosovës).

<sup>14</sup> Se cili ishte efekti i “federalizimit” të një shteti e kuptojmë nga shpjegimi që Gjingjiqi bënte me rastin e kërkesës së një politikani (Çanak) për autonomi më të madhe për Vojvodinën. Ai arsyetonte se: “Decentralizimi pa kontroll është feudalizim” dhe se “vetëm si shtet i cili funksionon si tërësi (unik) kemi shans për integrimet evropiane” (*Glas Javnosti*, 11 mars 2001)

<sup>15</sup> *Zoran Gjingjiq o Kosovu ...*, f. 39.

\* *KFOR* - Forcat ndërkombëtare për Kosovën të udhëhequra nga NATO, të dislokuara në Kosovë pas marrëveshjes së Kumanovës (10 qershor 1999) midis ushtrisë jugosllave dhe NATO-s.

\* *UNMIK* (United Nations Mission in Kosovo). Më 10 qershor 1999, Këshilli i Sigurimit të OKB aprovoi Rezolutën 1244 në të cilën parashihej ngritja e një administrate të përkohshme të kësaj organizate në Kosovë.

kryeministri serb paralajmëronte humbjen e “besueshmërisë të Bashkësisë Ndërkombëtare dhe të Serbisë demokratike”, përkatësisht dobësimin e forcave reformuese dhe demokratike serbe, si pasojë e dëshpërimit të serbëve përkitazi me qëndrimin e Bashkësisë Ndërkombëtare ndaj çështjes së Kosovës që nuk dallonte nga ai i kohës së “diktaturës në Serbi”<sup>16</sup>. Kryeministri serb u përkujdes që për “situatën e rëndë në Kosovë” dhe për nevojën imediate të zgjidhjes së statusit të saj dhe respektimit të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB, t’i bëjë me dije dhe liderët e kohës të gjashtë Fuqive të Mëdha, si Shtetet e Bashkuara të Amerikës (Bush), Rusia (Putin), Britania e Madhe (Bler), Gjermania (Shreder) dhe Italia (Berluskoni)<sup>17</sup>.

Insistimi i faktorit ndërkombëtar në formulën e M. Shtajnerit\* “standartet para statusit”, bëri që Gjingjiri të sprapset nga kërkesa për zgjidhjen e shpejtë të çështjes së statusit të Kosovës. Por ai këmbënguli që procesi i negociatave të fillojë menjëherë duke lënë të kuptohet se kohëzgjatja e tij nuk çonte peshë. Njëkohësisht, u shtrua kërkesa që në këtë proces të përfshihej Beogradi dhe që zgjidhja e statusit të Kosovës të nënkuptonte kompromis midis palësh<sup>18</sup>, duke theksuar se “statusi i Kosovës në fakt nënkupton statusin e Serbisë”<sup>19</sup>.

Siç shihet, nga vetë programi në vijim, “federalizimi” i Kosovës evidencohet edhe brenda opsionit të parë por formal, i cili do të duhej të përfundonte me ruajtjen e “integritetit territorial të Serbisë” (*Kosova më shumë se autonomi, më pak se republikë*), edhe brenda opsionit përfundimtar e të parapëlqyer nga pala serbe, e që ishte *ndarja territoriale e Kosovës e përcjellë me garanci efikase për serbët e mbetur në pjesën shqiptare dhe status të veçantë për objektet fetare serbe në këtë pjesë*.

<sup>16</sup> Zoran Gjingjiri o Kosovu ..., f. 39;

<sup>17</sup> Veçernje Novosti, 2 mars 2003.

\* Kryeadministratori i kohës për Kosovën.

<sup>18</sup> Zoran Gjingjiri o Kosovu ..., f. 36. “Ne në Beograd presim që bashkësia ndërkombëtare ta thotë qartë që në rrugëtimin për zgjidhjen e statusit për Kosovën, pozita e Beogradit do të merrej në konsideratë dhe që interesat e tij do të inkorporohen (brenda kësaj zgjidhjeje) si dhe që kjo zgjidhje do të bazohet në kompromis”.

<sup>19</sup> Po aty, f. 37.

### Si përfundim:

Përkundër faktit që Gjingjiq ishte eksponent i demokracisë serbe, i moderuar dhe me përgatitje të lartë akademike, në paraqitjet publike (shtyp, intervista televizive) në takimet diplomatike etj., ai pa ngurrim përdorte një gjuhë agresive, të ashpër e vulgare njollosjeje në adresë të shqiptarëve. Ai nuk kurseu asgjë nga arsenali propagandues antishqiptar i periudhës së Millosheviqit, qoftë para promovimit të këtij programi qoftë pas tij. Kosova dhe shqiptarët përcillehin me cilësime si: radikalizëm, ekstremizëm, terrorizëm, talebanë<sup>20</sup>, mafiozë<sup>21</sup>... për të bindur botën se i gjithë ky cilësim është “autenticitet” shqiptar. Me fjalë të tjera, sipas kryeministrit serb shqiptarët ishin një rrezik permanent dhe i madh me të cilin Serbia nuk mund t’ia dilte e vetme dhe pa ndihmën e faktorit ndërkombëtar. Një vizion dashakeqës përmes së cilit synohej përmbysja e realitetit të hidhur për Serbinë. Pra, jo Kosovë e pavarur dhe funksionale nën përkujdesjen e faktorit ndërkombëtar, por Kosovë e dështuar dhe e trajtuar me ndihmën e Serbisë e në interes të saj. Përkundër kësaj, edhe sot e kësaj dite është mendim i përhapur ndër gazetarë po dhe politikanë shqiptarë se ish kryeministri serb Zoran Gjingjiq, ka pasur qasje më objektive ndaj Kosovës, përkundër të gjithë të tjerëve para dhe pas tij. Ky mund të perceptohet si më i moderuar në krahasim me pararendësit e tij në relacion me Kosovën dhe shqiptarët, sepse siç shihet në Programin e tij nuk bëhet fjalë për shpërnguljen, eliminimin apo për përndjekjen e shqiptarëve. Po kështu, ky ishte pajtuar me faktin se Kosova si tërësi nuk mund të mbetej në kuadër të Serbisë. Por, ata që mendojnë se është e drejtë që shteti i Kosovës të mbijetojë si i pavarur dhe funksional në kufijtë e sotëm të tij, nga ky vështrim dhe dokumenti në vijim do të shohin se Gjingjiq nuk disonon shumë nga pararendësit dhe pasardhësit e tij politikë.

Siç shihet ky Program është i thuktë, i shkurtër, konkret, i qartë dhe me një gjuhë po kaq të qartë, të thjeshtë e të kuptueshme për të gjithë. E

<sup>20</sup> *Zoran Gjingjiq o Kosovu ...*, f. 52. “Çka është për Bushin Iraku për mua është Kosova-një çështje e rënd kombëtare dhe e sigurisë të cilën duhet patjetër ta zgjidhim...” deklaronte ai për shtypin gjerman në shkurt 2003.

<sup>21</sup> “...a mendojnë ata (amerikanët që angazhohen për Kosovën - E.B.) për fëmijët amerikanë të cilët vdesin nga droga të cilën e tregton mafia shqiptare në Amerikë dhe çka financohet me ato pare?” - deklaronte Gjingjiqi në një prononcim të tij publik. (*Politika*, 7 shkurt 2003).

megjithatë ka një teprim të qëllimtë terminologjik: sintagma “Kosovë e Metohi” nga e cila ishte hequr dorë që në kohën e Jugosllavisë komuniste (Kushtetuta e vitit 1974) evidencohet me dhjetëra herë (rreth 30 herë), gati në çdo fjali, madje herë-herë nga dy herë në një fjali.

Me rastin e përkthimit të këtij dokumenti nuk e kemi parë të arsyeshme që ta përshtatim në aspektin ortografik. Bie fjala, nëse “Serbëve” ose “Shqiptarët” është shkruar me germë të madhe, nuk kemi ndërhy pa marrë parasysh standardin gjuhësor në të dyja gjuhët, shqipe e serbishte\*, etj.

Programi:

“Z.Dj”.

Strategjia për K e M (Kosovë e Metohi-E. B.)<sup>22</sup>

### **Procesi aktual dhe rezultati probabil i tij**

Procesi aktual në Kosovë e Metohi parimisht është përcaktuar me Rezolutën 1244 dhe me Kornizën kushtetuese, ndërsa çështjet konkrete (p.sh. statusi ndërkombëtar i Kosovës e Metohisë në rrethana dhe organizma të ndryshëm) zgjidhen nga rasti në rast, por në pajtueshmëri më frymën e dokumenteve në fjalë. Pasi që kjo frymë bazohet në mohimin e çfarëdo lidhjeje të Serbisë dhe Kosovës e Metohisë, kjo manifestohet dhe në veprimtarinë e përditshme të strukturave ndërkombëtare në K e M.

Përderisa Rezoluta 1244 lenë mundësi kompromisi shtetëror (duke bërë fjalë për AUTONOMINË), Korniza kushtetuese eliminon çdo lidhje me Serbinë dhe Jugosllavinë.

Bashkësia ndërkombëtare më 1999 ka marrë të gjitha kompetencat në Kosovë dhe Metohi, me arsyetimin zyrtar që këto do t'i kryejë përderisa mos të gjendet një zgjidhje përfundimtare kompromisi. Ndërkaq, procesi real zhvillohet në atë mënyrë që këto kompetenca të barten gradualisht në strukturat e Kosovës e Metohisë, dhe me një dinamikë të përballueshme për këto struktura. Kur ky proces bartjeje të përfundojë, nuk do të mbetet asnjë kompetencë për të cilën do të mund të

\* Apo në rastet tjera K e M për Kosovë e Metohi, B e H për Bosnje e Hercegovinë, etj.

\* Zoran Gjingjiq.

<sup>22</sup> *Zoran Gjingjiq o Kosovu ...*, f. 12-17.

bisedohej me Beogradin, nëse fare do të ketë gjasa për një bisedim të tillë. Në ndërkohë, serbët e Kosovës do të përfshihen në institucionet e Kosovës e Metohisë, në mënyrë që i tërë koncepti të merr pamjen e një legjitimiteti politik.

### **Çka duhet të bëjë Serbia?**

Është e qartë që vendnumërimi është opsioni më i keq. Nëse përgjatë disa vitesh gjendja në Kosovë e Metohi përmirësohet ("standardet para statusit"), kjo do të konsiderohet si dëshmi se institucionet e shtetit të pavarur të Kosovës e Metohisë po funksionojnë. Nëse gjendja mbetet e njëjtë, kjo do të shpie drejt shpërnguljes së mëtejme të Serbëve. Në të dyja rastet, rriten shanset për shtetin e pavarur të shtrirë në gjithë territorin e Kosovës e Metohisë. Koha punon kundër interesave tanë në Kosovë e Metohi.

Prandaj Serbia duhet të marrë iniciativë vendimtare politike. Thelbi i kësaj iniciative duhet të jetë kërkesa që menjëherë qartësisht të definohen të drejtat dhe interesat e Serbisë në Kosovë e Metohi, si dhe mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të bashkësisë serbe në K. dhe M.

Iniciativa energjike së pari do ta hutojë dhe hidhërojë Bashkësinë ndërkombëtare, por në anën tjetër do ta detyrojë atë për një politikë më konsistente ndaj Serbisë dhe Kosovës e Metohisë.

Hapi i parë taktik është imponimi i temës. Shteti i pavarur i Kosovës e Metohisë më së lehti do të krijohet në errësirë dhe heshtje. Sapo të ndezët drita dhe sapo të fillojë shqyrtimi i hapur, shanset tona rriten.

Kërkesa e parë konkrete për të cilën duhet të insistojmë është kthimi i kontingjentit të ushtrisë dhe policisë, gjë që është paraparë me Rezolutën 1244. Duhet të kërkojmë datën e saktë të kthimit. Ka pak gjasa që kjo kërkesë të jetësohet, por përmes këtij insistimi krijojmë hapësirë për disa kërkesa tjera.

Si rrjedhojë e angazhimit tonë në planin ndërkombëtar të gjithë do ta kenë të qartë se Rezoluta 1244 nuk po zbatohet vetëm në ato pjesë të cilat mbrojnë interesat e Serbisë dhe Serbëve, dhe se Korniza kushtetuese e cila është duke u zbatuar, bazohet ekskluzivisht në elemente të cilët marrin në mbrojtje Shqiptarët.

Pra, kërkesa logjike vijuese është: revizioni ose së paku korrigjimi i Kornizës kushtetuese.

Kjo kërkesë mund të shtrohet në çastin e skadimit të afatit të paraparë për vlefshmërinë e Kornizës kushtetuese. Pasi që Rezoluta 1244

nuk zbatohet në mënyrë konsekuente, pasi që me zbatimin e Kornizës kushtetuese gjendja në Kosovë e Metohi nuk ka përparuar mjaftueshëm (janë kthyer vetëm 2% të përndjekurish), ne kemi të drejtë të kërkojmë disa mekanizma të ri për normalizimin e gjendjes.

### **Koncepti ynë**

Ajo që ne kërkojmë brenda Kornizës së re kushtetuese është: kushtetutshmëria e bashkësisë serbe në rendin kushtetues të Kosovë e Metohisë.

Kjo kushtetutshmëri (konstituivit) do të shprehet me një lloj federalizimi të Kosovë e Metohisë, me njohjen e entitetit serb si faktor politik i cili ka institucionet e veta përmes të cilëve realizon interesat e tij. Sipas këtij koncepti, sistemi politik i Kosovës e Metohisë do të bazohet në bashkëpunimin midis entitetit shqiptar dhe entitetit serb, me ç'rast çdonjëri entitet do t'i realizojë interesat e tij përmes institucioneve të veta, dyanshmërisht kompatible. Interesat e përbashkët do të realizoheshin përmes organeve të përbashkëta (ngjashëm me Federatën në B e H).

Në konceptin e ri duhet të futet e drejta e Serbisë për marrëdhënie të rregullta me entitetin serb, si dhe mekanizma efikas për mbrojtjen e monumenteve kulturore dhe fetare. Po kështu, pjesa e legjislacionit të cilin në mënyrë autonome e realizon entiteti shqiptar, patjetër duhet të jetë në harmoni me standardet e BE.

Serbia do ta pranonte një Kosovë e Metohi të federalizuar në këtë mënyrë, në një lloj lidhjeje asimetrike (më shumë se krahinë, më pak se republikë).

### **Pasojat e mundshme**

Nëse bashkësia ndërkombëtare dhe Shqiptarët do të praninin këtë propozim, në vitet vijuese do të testohej qëndrueshmëria e këtij koncepti. Qenësore është se përgjatë kësaj periudhe edhe Serbia edhe Serbët në Kosovë e Metohi, do të kishin "aksionin e art" të tyre në K e M, pa të cilin dhe kundër së cilit nuk do të ishte i mundshëm asnjë vendim i rëndësishëm.

Por, është më e besueshme që para së gjithash shqiptarët dhe pjesa më e madhe e bashkësisë ndërkombëtare, do të jetë kundër konceptit të propozuar.

Në këtë rast, Serbia duhet të kërkojë internacionalizimin e çështjes. Nëse Kosova e Metohija shkon drejt pavarësisë dhe nëse ne nuk mund ta parandalojmë këtë, duhet të kërkojmë:

- a) ndarjen territoriale
- b) garanci efikase ndërkombëtare për Serbët të cilët mbesin në pjesën shqiptare
- c) status të veçantë për objekte fetare.

### **Çka bëhet në ndërkohë**

Në ndërkohë, duhet të punojmë intensivisht në konceptin e vetëqeverisjes lokale në Kosovë e Metohi. Meqë koncepti në fjalë është pranuar nga organizatat ndërkombëtare, ky duhet të shfrytëzohet për krijimin e rrjetit të strukturave lokale serbe (këshillat lokalë, lidhja e bashkësive vendore dhe e fshatrave, etj).

Deputetët serbë në institucionet e Kosovës e Metohisë duhet të fillojnë me angazhim energjik në të mirë të tezës se Korniza kushtetuese nuk ka dhënë rezultate të duhura, se Rezoluta 1244 nuk është zbatuar, si dhe të kërkojnë zgjidhje të reja në drejtimin i cili është theksuar në konceptin tonë për federalizimin e Kosovës e Metohisë.

Të gjithë zyrtarët tanë në kontaktet ndërkombëtare theksin duhet ta vendosin në këto tema.

Duhet të bëjmë për vete disa nga anëtarët e Këshillit të Sigurimit dhe sa më shumë qeveri perëndimore.

Duhet të animojmë media perëndimore me ndikim (si Shpigll në Gjermani, Nju-Jork Tajm-sin dhe Vashington Post-in në ShBA, etj.).

### **Konkluzion**

Është momenti i fundit që të kalojmë në një aksion të vendosur. Arsyeya kryesore është që ne si pushtet jemi të detyruar që përfundimisht t'i definojmë interesat dhe të drejtat shtetërore në Kosovë e Metohi.

Ekzistojnë dhe arsye të tjera. Kanë përfunduar bisedimet për bashkësinë e Serbisë dhe Malit të Zi. Në radhë është puna në Kushtetutën e Serbisë, me ç'rast në parim duhet të dihet çka nënkupton suvereniteti i Serbisë. Së fundi, shumë shpejt kalon afati i Kornizës kushtetuese të përkohshme të Kosovës e Metohisë, gjë që gjithsesi do të rezultojë me një lloj deklarimi për pavarësi. Po kështu, na presin zgjedhjet republikane

---

në Serbi, me ç'rast nuk guxojmë të lejojmë që tema Kosovë e Metohi të bëhet pre e demagogëve dhe popullistëve.

Dhjetor 2002.”

